



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 168/5 Prot.

Tiranë, më 01.02.2018

VENDIM

Nr. 4, datë 31.01.2018

PËR

**KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE
PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 1, neni 76 pika 2, neni 135, bazuar në propozimet e njëjësive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 31.01.2018, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

I. Kandidatët që aplikojnë për pranim në programet e studimeve që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019, duhet të kenë notën mesatare minimale¹, si më poshtë:

1. Mjekësi e Përgjithshme	≥8.5
2. Farmaci	≥8.5
3. Stomatologji	≥8.5
4. Shëndet Publik	≥8
5. Infermieri e Përgjithshme	≥7.5
6. Fizioterapi	≥7.5
7. Mami	≥7.5
8. Teknikë Imazherie	≥7.5
9. Teknikë Laboratori	≥7.5
10. Logopedi	≥7.5

¹ Nota mesatare minimale përlllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm dhe mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.

II. Kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, përbëhet nga:

1. Nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore 35%, ku:

- a) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi (bërthamë), Fizikë (bërthamë), Biologji (bërthamë), nota e provimit shumëzohet me 1.15.
- b) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi (e thelluar), Fizikë (e thelluar), Biologji (e thelluar), nota e provimit shumëzohet me 1.25.
- c) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje, të ndryshme nga lëndët e përcaktuara në pikat a) dhe b) të sipërcituara, nota e provimit shumëzohet me koeficientin 1.

2. Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme (për të gjitha vitet) 35%

3. Nota mesatare aritmetike e lëndëve formuese, të zhvilluara gjatë viteve të shkollës së mesme 30%, përkatësisht:

- | | |
|-------------|-----|
| a) Kimi | 10% |
| b) Biologji | 10% |
| c) Fizikë | 10% |

II-1. Në shtojcën I dhe I-a, bashkëlidhur këtij vendimi, paraqiten në mënyrë tabelore, të përmbledhur, pikat I dhe II, si dhe lista e lëndëve që konsiderohen si lëndë formuese për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.


III. Koeficientet sipas llojeve të shkollave të mesme që do të aplikohen për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për të gjitha programet që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë janë sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Formula e përllogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të rankimit të kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit të ciklit Bachelor dhe të cikleve të integruara (Mjekësi, Stomatologji, Farmaci) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019, do të jetë si më poshtë vijon:

$$PP = \{ (M1 * 35) + [(MK * 10) + (MB * 10) + (MF * 10)] + [D1 + D2 + D3 + (Z1 * KZ1) + (Z2 * KZ2)] / 5 * 35 \} * KSHM * 100$$

Shpjegim:

PP	Pikë të përgjithshme për rankim;
M1	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë për të gjitha vitet e shkollës së mesme;
MK	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë e Kimisë së tri viteve të shkollës së mesme;
MB	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë e Biologjisë së tri viteve të shkollës së mesme;



MF	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë e Fizikës së tri viteve të shkollës së mesme;
D1	Provimi i detyruar i maturës 1;
D2	Provimi i detyruar i maturës 2;
D3	Provimi i detyruar i maturës 3;
Z1	Provim me zgjedhje i maturës 1;
Z2	Provim me zgjedhje i maturës 2;
KZ1, KZ2	Koeficientet e lëndëve me zgjedhje në maturën shtetërore do të jenë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> • Provime mature me zgjedhje lëndët bërthame Kimi, Fizikë, Biologji, KZ=1.15 • Provime mature me zgjedhje lëndët e thelluara Kimi, Fizikë, Biologji, KZ=1.25 • Të gjitha lëndët e tjera KZ=1
KSHM	Koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës nr. 2, në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik dhe u përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Arben Gjata



Shtojca I

Tabela Nr. 1: Kriteret e pranimit në formë të përmbledhur për programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	Master i Shkencave	Mjekësi e Përgjithshme	≥8.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2	Master i Shkencave	Farmacitë	≥8.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3	Master i Shkencave	Stomatologji	≥8.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4	Bachelor	Shëndet Publik	≥8	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	5	Bachelor	Infermieri e Përgjithshme	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	6	Bachelor	Fizioterapi	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	7	Bachelor	Mami	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	8	Bachelor	Teknik i Lartë Imazherie	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	9	Bachelor	Teknik i Lartë Laboratori	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	10	Bachelor	Logopedi	≥7.5	35%	35%	30%	Kimi 10%; Biologji 10%; Fizikë 10%

Shtojca I-a

Lista e lëndëve formuese për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

Gjatë zbatimit të formulës së pikëzimit dhe renditjes së aplikantëve për secilin prej programeve të studimit që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, duhet konsideruar:

Kimi:

Kimi e thelluar
Kimi e avancuar
Kimi me biokimi
Kimi organike
Kimi, kimi e aplikuar dhe teknike mjedisore
Përforcim kimi
Kimi analitike
Kimi fizike-koloidale
Kimi inorganike

Biologji:

Biologji me zgjedhje
Biologji e thelluar
Përforcim biologji
Biologji lëndë me zgjedhje të detyruar

Fizikë:

Fizikë e avancuar
Fizikë e thelluar
Fizikë lëndë me zgjedhje
Fizikë lëndë me zgjedhje të detyruar
Fizikë dhe fizikë e aplikuar
Fizikë e zbatuar
Fizikë radiologjike
Fizikë-Kimi
Fizikë-1

Nota e lëndës “Shkenca natyrore” e kurrikulës bërthamë, llogaritet si notë për Kiminë, Biologjinë dhe Fizikën

Shtojca II

Tabela Nr. 2: Koeficientet sipas llojit të shkollës së mesme që kanë përfunduar kandidatët, të cilët aplikojnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019

1	GJIMNAZ	1.4
2	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-FRËNGJISHT	1.4
3	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-ITALISHT	1.4
4	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT	1.4
5	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	1
6	GJIMNAZ GJUHËSOR	1
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	1
8	SHKOLLË SPORTIVE	1
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	1
10	HOTELERI-TURIZËM	1
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	1
12	MEKANIKË	1
13	ELEKTROTEKNIKË	1
14	ELEKTRONIKË	1
15	PËRPUNIM DRURI	1
16	NDËRTIM	1
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	1
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1
19	BUJQËSI	1
20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	1
21	VETERINARI	1
22	GJEODEZI	1
23	INSTALUES SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	1
24	LLOGARI	1
25	SHËRBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TË DHËNASH	1
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK	1
29	ELEKTRONIKË NE TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT	1
30	SILVIKULTURË	1
31	HARRY FULTZ, BIZNES	1
32	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	1
33	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	1
34	PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI	1
35	PROFILE TË TJERA QË NUK JANË TË LISTUARA	1